

VENDIM
Nr. 145, datë 26.11.2015

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
GSA SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE,
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s
NR. 57, DATË 22.6.2011**

Në mbështetje të neneve 16; 20, germa “b”, 37, germa “d” , dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “g”; 10, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 16, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k., për rinovimin e licencës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/10, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “GSA” sh.p.k. për rinovimin e licencës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 57, datë 22.6.2011.

2. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti